



Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

Qeveria – Vlada – Government



Ministria e Punëve të Brendshme

Ministarstvo Unutrašnjih Poslova / Ministry of Internal Affairs

AGJENCIA E KOSOVËS PËR FORENZIKË

Kosovska Agencija Forenziku | Kosovo Agency on Forensic

**Strategjia Zhvillimore e
Agjencisë së Kosovës për Forenzikë
2016-2020**

2003

Përmbatja

Kapitulli I: Hyrje.....	4
1.1 Qëllimi.....	4
1.2 Sfondi	5
1.3 Përkufizimi i termave dhe lista e shkurtesave	6
Kapitulli II: Metodologjia.....	10
Kapitulli III: Korniza ligjore dhe institucionale	11
3.1 Korniza ligjore.....	11
3.2 Korniza institucionale.....	11
Kapitulli IV: Objektivat e strategjisë zhvillimore.....	13
Objektivi I: PËRMIRËSIMI I KUSHTEVE DHE HAPËSIRAVE	13
1.1 Zgjerimi dhe krijimi i hapësirës së mjaftueshme dhe të përshtatshme për punë.....	13
1.2 Blerja, furnizimi me pajisje, aparaturë dhe teknologji bashkëkohore në fushën e forenzikës	14
Objektivi i përgjithshëm II: ZHVILLIMI I KAPACITETEVE NJERËZORE.....	14
2.1 Zhvillimi i qëndrueshëm dhe profesionalizimi i resurseve njerëzore	14
2.2 Kontrolli i cilësisë dhe sigurisë përmes akreditimit dhe testeve profesionale	15
2.3 Hulumtime Shkencore në Bashkëpunim me MASHT dhe UP	15
Objektivi i përgjithshëm III: FORCIMI I BASHKËPUNIMIT NDËR-INSTITUCIONAL	16
3.1 Memorandume mirëkuptimi dhe bashkëpunimi.....	16
3.2 Organizimi i përbashkët i takimeve, trajnimeve, seminareve, konferencave ndër-institucionale	16
Objektivi i përgjithshëm IV: RRITJA E BASHKËPUNIMIT NDËRKOMBËTARË	17
4.1 Anëtarësimi në organizata-asociacione ndërkombëtare	17
4.2 Organizimi dhe pjesëmarrja në konferenca rajonale dhe ndërkombëtare	17
4.3 Ngritja e bashkëpunimit me laboratorët e shteteve të rajonit	18
Kapitulli V: Zbatimi, monitorimi dhe vlerësimi i strategjisë	19
Kapitulli VI: Plani i Veprimit 2016-2020	20

Përmbledhje ekzekutive

Ky dokument strategjik është hartuar nga Agjencia e Kosovës për Forenzike si bartëse e kësaj strategjie. Kjo strategji është draftuar në bashkëpunim me institucionet tjera të Republikës së Kosovës, përshirë MPB-në, PK, MASHT, EULEX, KGJK, KPK, IML dhe me mbështetje të OSBE. Kjo strategji është përmbledhur në katër (4) objektiva të përgjithshme të zhvillimit të AKF-së që do të realizohen gjatë viteve 2016-2020. Ajo gjithashtu përmban objektivat specifike në kuadër të objektivave të përgjithshme dhe një plan veprimi me aktivitete të caktuara të cilat duhet të arrihen për një realizim të suksesshëm të kësaj strategjie.

Realizimi i Strategjisë Zhvillimore të Agjencisë së Kosovës për Forenzikë 2016-2020, do të mbështetet në buxhetin e ndarë vjetor dhe me mbështetje shtesë nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Realizimi i objektivave të përcaktuara në këtë strategji ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë apo te tërthortë në realizimin e objektivave shtetërore të përcaktuara si politika të përgjithshme të Republikës së Kosovës në fushën e konsolidimit dhe forcimit të institucioneve të sigurisë dhe drejtësisë, ngritjes së kapaciteteve institucionale, bashkëpunimit institucional, anëtarësimit dhe bashkëpunimit me organizata ndërkombëtare.

Strategjia Zhvillimore 2016-2020 paraqet një dokument të rëndësishëm dhe orientues përforcimin dhe zhvillimin jo vetëm për Agjencinë e Kosovës për Forenzikë por edhe për institucione tjera të sigurisë dhe drejtësisë, për të cilat në kryejmë shërbime forenzike.

Për realizim të plotë të kësaj strategjie AFK-ja do të mbështetet edhe në fondet, ndihmat apo donacionet e ndryshme nga vende, organizata dhe partner ndërkombëtarë.

Në Strategjinë Zhvillimore të Agjencisë së Kosovës për Forenzikë 2016-2020, objektivat e përgjithshme që do të realizohen janë:

1. Përmirësimi i kushteve dhe hapësirave për punë
2. Zhvillimi i kapaciteteve njerëzore në kuadër të AKF-së
3. Forcimi i bashkëpunimit ndër-institucional
4. Rritja e bashkëpunimit ndërkombëtar lidhur me ekspertizat forenzike

Kapitulli I: Hyrje

Agjencia e Kosovës për Forenzikë është një institucion shtetëror me një veprimtari dhe funksion shumë specifik në tërë mekanizmin shtetëror të Kosovës. Kryerja me sukses e detyrave dhe përgjegjësi të përcaktuara me ligj kërkon trajtim dhe qasje të veçantë, për shkak të natyrës së punës që kryen AKF-ja. Pasi që AKF është institucion relativisht i ri, kërkohet trajtim dhe qasje e veçantë në kuptim e mbështetjes financiare për zhvillimin e mëtejshëm të kapaciteteve operative, teknike dhe resurseve humane. Këto konsiderata janë mirë të konsoliduara fal mbështetjes së Qeverisë së Republikës së Kosovës por edhe të shumë vendeve dhe organizatave ndërkombëtare që kanë mbështetur dhe vazhdojnë të mbështesin Agjencinë e Kosovës për Forenzikë.

Agjencia e Kosovës për Forenzikë do të vazhdojë misionin e saj për kryerje të shërbimeve forenzike në mënyrë të pavarur, të paanshme, objektive dhe në përputhje me standardet vendore dhe ndërkombëtare të cilësisë dhe sigurisë. Divizionet-laboratorët e AKF-së, janë të akredituara nga Drejtoria e Akreditimit të Kosovës dhe në procesin e vlerësimit kanë marrë pjesë ekspert të fushës forenzike nga Holanda dhe Turqia. Prandaj duke i pranuar dhe zbatuar standardet vendore dhe ndërkombëtare të cilësisë dhe sigurisë së shërbimeve forenzike, AKF-ja ofron dhe garanton saktësi, objektivitet dhe besueshmëri për shërbimet forenzike që kryhen për institucionet e sigurisë dhe drejtësisë në Republikën e Kosovës.

Andaj, arritja në këtë nivel të konsolidimit, Agjencisë së Kosovës për Forenzikë e bënë më të lehtë që zhvillimin e mëtejshëm ta orientojmë drejtë një qëndrueshmërie institucionale në kuadër të sistemit të sigurisë dhe drejtësisë në vendin tonë, me shkallë të lartë të profesionalizmit, me veprimtari operacionale të pavarur, me kapacitete të reja hapësinore e bashkëkohore në fushën e forenzikës, me resurse njerëzore profesionale, me funksionalizim të laboratorëve të ri në fushën e forenzikës, rritje të bashkëpunimit ndërinstitucionalë, anëtarësim dhe bashkëpunim në organizata ndërkombëtare, që janë si pikësnyimet dhe orientimet e AKF-së, e për të cilat do të punohet shumë në të ardhmen për realizimin e tyre.

1.1 Qëllimi

Qëllimi i kësaj Strategjie, është të vendos objektivat e përgjithshme për zhvillimin e mëtejshëm të AKF-së. Kjo strategji zhvillimore ka për qëllim të kontribuoj në luftën kundër kriminalitetit në

përgjithësi, terrorizmit, krimit të organizuar, trafikimit me qenie njerëzore, narko-kriminalitetit, armë mbajtje pa leje dhe formave tjera të krimit. Kjo do të bëhet përmes aplikimit të metodave të ndryshme shkencore për identifikimin e kryerësve të këtyre veprave penale.

1.2 Sfondi


Agjencia e Kosovës për Forenzikë është Agjenci e pavarur ekzekutive në kuadër të MPB-së, funksionon nga viti 2011, me një trashëgimi të pasur nga Policia e Kosovës si pjesë e sëlilës ka qenë. AKF-ja është institucioni përgjegjës për ofrimin e paanshëm, të analizave objektive shkencore forenzike, e cila kryen veprimet me urdhër të gjykatës, prokurorisë apo me kërkesë të agjencive të zbatimit të ligjit, po ashtu ofron shërbime edhe për organet shtetërore sipas ligjit në fuqi. Në kuadër të Agjencisë së Kosovës për Forenzikë, janë tre (3) departamente dhe shtatë (7) divizione (laboratorë) funksionale. Numri i përgjithshëm i të punësuarve në AKF, është 52. Udhëheqja strategjike është përgjegjësi e Kryeshefit ekzekutiv. Kryeshefi ekzekutiv ndihmohet nga menaxheri i cilësisë dhe zëvendës menaxheri i cilësisë. Drejtorët e departamenteve janë përgjegjës për udhëheqje të përgjithshme të departamenteve në kuadër të AKF-së. Po ashtu ka edhe pesë (5) personel administrativ, katër (4) personel mbështetës në administrim të provave, ndërsa pjesa tjetër janë punonjës të nivelit shkencor, përkatësisht ekspert që kryejnë dhe verifikojnë ekspertizat e kryera në laboratorët përkatës.

AKF-jë është e mandatuar për kryejn ekspertiza forenzike, nga fusha e Balistikës, Daktiloskopisë dhe Traseologjisë, Dokumenteve dhe Dorëshkrimeve, Serologjisë dhe ADN-së, Analizave Kimike të Narkotikëve, Zjarrëvënjeve, Eksplozivëve dhe Grimcave të Barotit, Ekzaminimet e Kompjuterëve, Ekzaminimi i Videos, Audios dhe Zërit. Agjencia e Kosovës për Forenzikë, po ashtu posedon edhe dhomën e ruajtjes së provave dhe dëshmime në pajtueshmëri me praktikat më të mira të normave ndërkombëtare.

Për mbështetje të veprimtarisë së sajë AKF-ja administron me 4 sisteme elektronike. Ato janë LIMS, i cili është një softuer-bazë laboratorike dhe sistem për menaxhim informativ me mundësi mbështetëse për laborator modern. përkatësisht baza të të dhënave forenzike, përshtirë LIMS.AFIS i cili është një sistem automatik për identifikim të gjurmës së gishtit, i cili përdor metodologjinë për identifikim biometrik duke përdorur teknologjinë e imazhit digjital për nxjerrjen, ruajtjen dhe analizën e të dhënave të gjurmëve të gishtave. CODIS i cili është një

sistem indeks për ADN për mbështetje në procedim penal bazuar në provë të ADN-së dhe IBIS i cili është një sistem i integruar për identifikim balistik.

1.3 Përkufizimi i termave dhe lista e shkurtesave



AAFS	American Academy of Forensic Science
ADN	Acidi dezoksiribonukleik
AFIS	Sistemi për Identifikim Automatik të Gjurmëve të gishtërinjve
AKF	Agjencia e Kosovës për Forenzikë
AKREDITIM	Nënkupton procedurën e njohjes zyrtare, të kompetencës së një organi për vlerësimin e konformitetit në përputhje me standardet dhe me rregullat teknike për të kryer detyra, si: testim, kalibrim, certifikim ose inspektim
CODIS	Combined DNA IndexSystem – Databazë për ADN
CTS	Shërbimet Testuese të Zotësisë
DËSHMI	Dokumenti, prova që dëshmon ndonjë fakt të caktuar
IML	Instituti për Mjekësi Ligjore
DT	Departamenti i Traseologjisë
DTI	Departamenti për Teknologji Informativ

EKSPERTIZË

Hulumtimi, hetimi, gjurmimi, vlerësimi apo studimi i provuar, përfshirë edhe raportet nga këto aktivitete, konstatimet dhe rezultatet që kërkojnë njohuri specifike dhe të cilat kryhen nga ekspertë për të vërtetuar dhe dhënë mendimin mbi faktet e caktuara

ENCASE

Program digjital forenzik për ekzaminime kibernetike

ENFSI

Rrjeti Evropian i Instituteve Shkencore Forenzikë

EULEX

Mision Evropian në Kosovë për zbatim të ligjit

FTI

Forenzika e Teknologjisë Informative

HULUMTIM

Vepër e shkruar, në të cilën është shqyrtuar një çështje apo paraqiten të dhënat që janë mbledhur nga kërkimet për një çështje, gjurmime, gjetje ose arritje shkencore;

IAFI

International Association of Forensic Institutes;

IBISS

Sistemi i Integruar për Identifikime Balistike;

ICITAP

Program për ndihmë dhe trajnim ndërkombëtar për hetimet kriminale;

ISO STANDARDI

Standardi ndërkombëtar icilësisë

ISO

Organizatën Ndërkombëtare të Standardizimit

KGJK

Këshilli gjyqësor i Kosovës

KPK

Këshilli prokurorial i Kosovës

LABORATOR	Nënkupton divizionin e caktuar në kuadër të AKF-së që merret me veprimtari shkencore të ekspertimit
LIMS	Sistemi i Menaxhimit të Informatave në Laborator
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
METODA	Nënkupton veprimet shkencore që aplikohen nga njësitet e caktuara në kuadër të AKF-së gjatë kryerjes së ekspertimit
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
PK	Policia e Kosovës
PROVË	Vërtetimi i të dhënave që duam të njohim a ta studiojmë më thellë: eksperiment që bëhet për të marrë të dhëna për diçka, për të kontrolluar saktësinë e diçkaje, veprim paraprak që bëhet për të kontrolluar apo vërtetuar saktësinë e një lloji, një gjëje, a mase të diçkaje, duke u mbështetur në fakte a dëshmi. Prova është e dhënë që vërteton ose mohon diçka;
STANDARDI	Nënkupton rregullat e aplikuara nga ISO –ja për akreditimin e laboratorëve testues dhe kalibrues;
SEM	Mikroskopi elektronik skanues;
SHBA-	Shtetet e Bashkuara të Amerikës;

SHKENCA E FORENZIKËS

Aplikimi i shkencave (kimi, biologji, fizikë, matematikë, inxhinieri, makineri, kriminalistikë, etj.) për gjetjen, identifikimin, individualizimin, analizimin dhe vlerësimin e dëshmive fizike (provave materiale) për çështje ligjore penale dhe civile;

UP

Universiteti i Prishtinës;



Kapitulli II: Metodologjia

Strategjia Zhvillimore e Agjencisë së Kosovës për Forenzikë 2016-2021, është hartuar nga zyrtarë të saj në bashkëpunim me MPB-në, PK, KGJK, KPK, IML, dhe partnerët ndërkombëtare OSCE, EULEX, ICITAP, UNDP.

Grupi i Punës për hartimin e këtij dokumenti strategjik është themeluar në bazë të Vendimit nr. 311/2015 të datës 15.10.2015 Ministrit të MPB-së. Zyrtarët e AKF-së fillimisht kanë hartuar draftin fillestar i cili iu është prezantuar të gjithë anëtarëve të Grupit Punues për diskutim dhe ofrim të komenteve.

Grupi Punues ka mbajtur takime të rregullta me qëllim të finalizimit të këtij dokumenti, i cili është mbështetur nga OSBE, dhe është miratuar në bashkëpunim me MPB.



Kapitulli III: Korniza ligjore dhe institucionale

3.1 Korniza ligjore

Kjo strategji zhvillimore është në përputhje me legjislacionin në fuqi të Republikës së Kosovës që ndërlidhet me fushën e forenzikës dhe përfshinë, por nuk kufizohet në:

- Ligji nr. 04/L-064 për Agjencinë e Kosovës për Forenzikë;
- Ligji nr. 04/L-076 për Policinë;
- Ligji nr. 03/L-231 për Inspektoratin Policor të Kosovës;
- Ligji Nr. 05/L-060 Instituti për Mjekësinë Ligjore;
- Ligji nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale;
- Ligji nr. 03/ L-183 për Zbatimin e Sanksioneve Ndërkombëtare;
- Ligji nr. 04/L-213 për Ndihmën Juridike Ndërkombëtare në Çështje Penale;
- Kodi nr. 04/L-082 Penal i Republikës së Kosovës;
- Kodi nr. 04/L-123 i Procedurës Penale;
- Kodi nr. 03/L-193 i Drejtësi për të Mitur.
- Ligji nr. 05/L -022 Për Armë;
- Ligji nr. 05/L -017 Për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-246 për pajisje me armë, municion dhe pajisje përkatëse të sigurisë për institucionet e autorizuara shtetërore për siguri.

3.2 Korniza institucionale

Mekanizmi institucional përfshinë të gjithë mekanizmat të cilët kanë rol dhe përgjegjësi në fushën e forenzikës në Republikën e Kosovës, dhe përfshinë këto institucione:

Ministria e Punëve të Brendshme- Përmes mekanizmave dhe agjencive të saj, ndihmon në sigurimin e informacioneve si dhe ndërmerr aktivitetet në parandalimin, mbrojtjen, ndjekjen dhe reagimin ndaj të gjitha akteve kriminale.

Agjencia e Kosovës për Forenzikë- Është institucioni përgjegjës për ofrimin e paanshëm, të analizave objektive shkencore forenzike, e cila kryen veprimet me urdhër të gjykatës, prokurorisë apo me kërkesë të agjencive të zbatimit të ligjit, poashtu ofron shërbime edhe për organet shtetërore sipas ligjit përkatës në fuqi.

Policia e Kosovës - Është mekanizëm institucional në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme e cila merret me ruajtjen e rendit të sigurisë, parandalon, ndjek dhe zbulon kryerësit e veprave penale dhe detyra tjera të përcaktuara me ligj.

Ministria e Drejtësisë- Zhvillon politikat, mundëson përgatitjen dhe zbatimin e legjislacionit në fushën e drejtësisë.

Instituti për Mjekësinë Ligjore-Është përgjegjës për menaxhimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve mjeko-ligjore bazuar në standardet e njohura ndërkombëtare dhe praktikën më të mira Evropiane për të siguruar shërbime mjeko ligjore, mësimdhënie, hulumtime dhe shërbime përkrahëse për familjet e personave të zhdukur.

Prokuroritë dhe gjykatat – Janë institucionet përgjegjëse për hetimin, ndjekjen penale të kryerësve të veprave penale, gjykimin dhe dënimin sipas ligjit për kryerësit e veprave penale, konfiskimin e pasurisë dhe pasurive të fituara përmes kryerjes së veprave penale.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë-Luan rol të rëndësishëm në ngritjen e vetëdijes dhe ndërgjegjësimin e të rinjve lidhur me ruajtjen nga terrorizmi, parandalimi i përdorimit të narkotikëve dhe aktivitetet tjera me rrezik për sigurinë e fëmijëve. Poashtu përfshin dhe trajton këto tema në kurrikula, aktivitete të ndër-kurrikulare dhe në përmbajtje të programeve.

Strategjia Zhvillimore e Agjencisë së Kosovës për Forenzikë 2016-2020 është në përputhje dhe mbështet strategjitë dhe planifikimet tjera të Republikës së Kosovës:

- Plani Vjetor i Punës së Qeverisë për vitin 2016
- Programi Kombëtar për Zbatimin e MSA-së
- Plani Zhvillimor Strategjik 2016-2020 i Policisë së Kosovës
- Strategjia për Asistencë në Sektorin e Sundimit të Ligjit në Kosovë 2016-2019
- Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës kundër Terrorizimit 2012-17
- Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës kundër Narkotikëve 2012-17
- Strategjia e Kombëtare e Republikës së Kosovës kundër Krimit të Organizuar 2012-2017
- Strategjia për Kontrollin dhe Mbledhjen e Armëve të Vogla dhe të Lehta 2013-16;
- Strategjia Shtetërore për Sigurinë Kibernetike 2016-2019.

Kapitulli IV: Objektivat e strategjisë zhvillimore

Strategjia Zhvillimore e Agjencisë së Kosovës për Forenzikë 2016-2020 përbëhet prej katër objektivave të përgjithshëm:

1. Përmirësimi i kushteve dhe hapësirave për punë.
2. Zhvillimi i kapaciteteve njerëzore.
3. Forcimi i bashkëpunimit ndër-institucional.
4. Rritja e bashkëpunimit ndërkombëtarë.

Objektivi I: PËRMIRËSIMI I KUSHTEVE DHE HAPËSIRAVE

Agjencia e Kosovës për Forenzikë në funksion të zgjerimit dhe krijimit të kushteve sa më të mira dhe të përshtatshme për punë, ka filluar ndërtimin e një objekti shtesë, i cili do të funksionalizimet gjatë vitit 2017, me ç 'rast do të krijohen kushte optimale me hapësirë të mjaftueshme për laboratorët ekzistues, si dhe për laboratorët që do të funksionalizohen gjatë viteve të ardhshme. Ky objektiv do të ndihmoj në pajisjen me aparaturë dhe teknologji të avancuar për laboratorët ekzistues dhe për laboratorët që do të funksionalizohen në të ardhmen për fusha të reja të ekspertizave forenzike, përfshirë kryerjen e analizave të ADN-së, për rastet në konteste civile nga Divizioni i Serologjisë dhe ADN-së dhe krijimi i kushteve dhe mjeteve të punës për punë në terren, përfshirë mjete transporti.

1.1 Zgjerimi dhe krijimi i hapësirës së mjaftueshme dhe të përshtatshme për punë

Agjencia e Kosovës për Forenzikë, veprimtarin e saj e ushtron në objektin e ndërtuar në vitin 2003. Me zhvillimin e kapaciteteve të ekspertizës ky objekt nuk vazhdon të jetë i përshtatshëm në raport me rritjen e kërkesave. Hapësira e pamjaftueshme është duke penguar stafin e AKF të realizojë mandatin ligjorë dhe të kryej analiza shkencore sipas standardit i cili kërkohet. Nisur nga kjo gjendje në vitin 2015, AKF-ja, ka filluar realizimin e projektit që ka për qëllim ndërtimin e një objekti shtesë i cili planifikohet të hyjë në funksion në vitin 2017. Ky objekt do të i bashkëngjitet infrastrukturës ekzistuese dhe do të ketë hapësirë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e shërbimeve ekzistuese dhe zhvillimin e fushave tjera për ekspertizë forenzike.

1.2 Blerja, furnizimi me pajisje, aparaturë dhe teknologji bashkëkohore në fushën e forenzikës

Me qëllim të forcimit të kapaciteteve forenzike ekzistuese dhe kapaciteteve të reja forenzike, është e domosdoshme blerja dhe pajisja e laboratorëve të Agjencisë së Kosovës për Forenzikë, me pajisje dhe aparaturë forenzike bashkëkohore. Këto pajisje do të zëvendësojnë pajisjet që përdoren aktualisht nga Agjencisë së Kosovës për Forenzikë të cilat janë në përdorim që nga viti 2003. Këto pajisje kanë filluar të amortizohen dhe nevoja për zëvendësim të tyre me pajisje dhe aparaturë të re është e domosdoshme në mënyrë që të arrihen standardet të larta të sigurtisë dhe cilësisë së shërbimeve forenzike në fushat e: Balistikës, Traseologjisë, Daktiloskopisë, Dokumenteve, Serologjisë dhe ADN-së, Narkotikëve, Eksplozivëve, Ekzaminimeve të Kompjuterëve, Ekzaminimit të Videos, Audios dhe Zërit.

Objektivi i përgjithshëm II: ZHVILLIMI I KAPACITETEVE NJERËZORE

Duke pasur parasysh rolin dhe funksionin që kanë resurset njerëzore në kryerjen e misionit dhe mandati të çdo organizate apo institucioni, AKF-ja do t'i kushtoj vëmendje të veçantë zhvillimit të qëndrueshëm të resurseve njerëzore me qëllim ruajtjen e tyre, zhvillimin e mëtejshëm profesional në kohezion me trendët dhe zhvillimet në fushën e forenzikës, rekrutimin e resurseve njerëzore, ngritjen e cilësisë dhe sigurtisë së shërbimeve forenzike dhe realizimin e hulumtimeve shkencore.

2.1 Zhvillimi i qëndrueshëm dhe profesionalizimi i resurseve njerëzore

Vëmendje e veçantë do t'i jepet rritjes, zhvillimit dhe ngritjes së mëtejshme profesionale të punonjësve si pjesë integrale e zhvillimit të AKF-së. Rëndësi të veçantë do t'i kushtohet zhvillimit të plan programeve të trajnimeve të specializuara, në funksion të plotësimit të nevojave të divizioneve –laboratorëve për cilësi dhe siguri. Menaxhmenti i AKF-së do të organizoj trajnime shkencore forenzike brenda institucionit me ekspertë të ndryshëm nga fusha e forenzikës. Kjo do të mundësojë dhe lehtësojë pjesëmarrjen e personelit të AKF-së në trajnime, seminare e konferencave brenda dhe jashtë vendit. AKF, gjithashtu, vëmendje të veçantë, do t'i

kushtojë kujdesit shëndetësor për personelit e vet duke kryer kontrollet e rregullta mjekësore një herë në vit dhe do të mundësoj ngritje menaxheriale përpunonjësit e vet.

2.2 Kontrolli i cilësisë dhe sigurisë përmes akreditimit dhe testeve profesionale

Misioni i AKF-së është ofrimi i shërbimeve forenzike cilësore, të sigurta dhe të besueshme, bazuar në këto vlera dhe ligjin për AKF-në i cili përcakton si detyrim ligjor akreditimin e laboratorëve, AKF-ja do t'i kushtoj rëndësi të madhe kontrollit të cilësisë dhe sigurisë së shërbimeve forenzike përmes procesit të akreditimit dhe ri akreditimit të laboratorëve të Agjencisë së Kosovës për Forenzikë sipas standardeve ndërkombëtare të cilësisë ISO17025. Me mbështetje të partnerëve ndërkombëtarë pesë (5) laboratorë të AKF-së janë akredituar, ndërsa në plan për tu akredituar janë disa laboratorë tjerë dhe të njëjtën kohë vazhdimi i procesit të riakreditimit çdo 4 vit për divizionet-laboratorët përkatës. Poashtu, në funksion të ruajtjes, kontrollit dhe ngritjes së cilësisë dhe sigurisë së shërbimeve forenzike, punonjësit e AKF-së, do të testohen përmes testeve profesionale ndërkombëtare apo testeve të brendshme të administruara nga AKF-ja.

2.3 Hulumtime Shkencore në Bashkëpunim me MASHT dhe UP

Me Ligjin për AKF-në, është përcaktuar kryerja e hulumtimeve shkencore në fushën e forenzikës. Duke e parë këtë si mundësi për zhvillim shkencor për AKF-në, në pajtim me MASHT, dhe UP duke shfrytëzuar mundësitë dhe potencialin akademik në UP, potencialin praktik-konkret dhe të pajisjeve në AKF, do të realizojë hulumtime të përbashkëta shkencore në fushën e forenzikës në bashkëpunim me Fakultetin e Shkencave Natyrore të UP. Ky objektivi do të realizohet përmes memorandumeve të bashkëpunimit me UP, ku do të rregullohen aspektet të ndryshme, si : hartimin e përbashkët të plan programit të trajnimeve UP-AKF, mundësi e praktikës për nivelet e caktuara të studimeve Master, Doktoratë në laboratorët e AKF-së, kriteret që do të përdoren për përfituesit e kësaj mundësie, hulumtime të përbashkëta për zhvillimin e metodave të reja dhe specifike në fushën e forenzikës, publikimi i hulumtimeve etj. Realizimi i këtij objektivi do të mundësonte zhvillimin dhe ngritjen e kuadrove të reja në fushën e forenzikës, e kuadro të tillë janë të nevojshëm në sektorët e sigurisë dhe drejtësisë, pastaj do të afirmonte vendin tonë në këtë drejtim duke sjellë së bashku

ekipet ndërdisiplinore të AKF-së dhe bashkëpunëtorët e jashtëm, nga agjencitë e zbatimit të ligjit dhe hulumtuesit nga universitete dhe institucionet shkencore të lëmisë së forenzikës, do të mundësonte zhvillimin e metodave të reja dhe specifike në fushën e forenzikës, mundëson praktikë pas-universitare përmes udhëheqjes së ekspertëve të Agjencisë së Kosovës për Forenzikë, si dhe rritjes profesionale nëpërmjet këshillimit individual dhe në ekip të bazuar për mentorim.

Objektivi i përgjithshëm III: FORCIMI I BASHKËPUNIMIT NDËR-INSTITUCIONAL

Agjencia e Kosovës për Forenzikë, është një institucion shtetëror që ka mision kryerjen e shërbimeve forenzike me kërkesë apo urdhër të institucioneve dhe organeve për zbatim të ligjit në Kosovë. Bashkëpunimi dhe komunikimi me këto institucione është i domosdoshëm në funksion të kryerjes së detyrave të përcaktuara me ligj. Për të rritur dhe forcuar bashkëpunimin dhe komunikimin me PK, KGJK, KPK, IML, dhe institucionet tjera të zbatimit të ligjit, AKF-ja do inicioj marrëveshje mirëkuptimi dhe bashkëpunimi, do të kërkoj dhe ofrojë ndihmë dhe ekspertizë profesionale për hartim të akteve ligjore dhe nënligjore, do të ftoj dhe organizoj takimeve-mbledhjeve të përbashkëta vjetore, do të organizoj trajnime në fushën e forenzikës.

3.1 Memorandume mirëkuptimi dhe bashkëpunimi

Lidhur me këtë objektiv specifik, AKF-ja do të inicioj memorandume mirëkuptimi dhe bashkëpunimi për fusha të përbashkëta në funksion të bashkëpunimit dhe komunikimit ndërinstitutional. Këto memorandume do të arrihen me PK, KGJK, KPK, EULEX, IML, MASHT, UP dhe Institucionet tjera të vendit.

3.2 Organizimi i përbashkët i takimeve, trajnimeve, seminareve, konferencave ndërinstitutionale

AKF-ja do të organizoj trajnime, seminare e konferenca të përbashkëta me PK, KGJK, KPK, IML dhe Institucionet tjera të zbatimit të ligjit në Kosovë për t'i njoftuar rreth arritjeve shkencore, profesionale, publikimeve vendore dhe ndërkombëtare në fushat e forenzikës, zhvillimit të metodave të reja të punës, rreth ndryshimeve ligjore, shërbimeve të reja forenzike, trajtimin e provave me qëllim të evitimit të dëmtimeve, degradimeve dhe kontaminimeve të provave materiale për të arritur rezultate sa më të mira. AKF poashtu do të organizoj takime

vjetore me drejtues të lartë të institucioneve përkatëse për trajtimin dhe zgjidhjen e problemeve të ndryshme që paraqiten në punët dhe detyrat e përbashkëta.

Objektivi i përgjithshëm IV: RRITJA E BASHKËPUNIMIT NDËRKOMBËTARË

Agjencia e Kosovës për Forenzikë në kuadër të veprimtarisë së saj synon të forcoj bashkëpunimin me institucione forenzike dhe organizata të karakterit regjional dhe ndërkombëtare në fushën e forenzikës, duke pasur parasysh se në ditët e sotme është i rëndësishëm bashkëpunimi ndërkombëtar për arsye të njoftimit dhe shkëmbimit të informatave, njohurive, praktikave të reja në lëmin e forenzikës. AKF-ja, synon anëtarësimin në organizata dhe asociacione ndërkombëtare në fushën e forenzikës, bashkëpunimin me agjencitë apo laboratorë të shteteve tjera për kryerje tender sjellë të shërbimeve forenzike të caktuara të cilat nuk mund të kryhen në AKF dhe anasjelltas dhe pjesëmarrjen e personelit në trajnime, konferenca dhe seminare forenzike të karakterit ndërkombëtar.

4.1 Anëtarësimi në organizata-asociacione ndërkombëtare

Bashkëpunimin ndërkombëtar në lëmin e forenzikës është njëri ndër objektivat specifike të rëndësishme në kuadër të kësaj strategjie. Realizimi i këtij objekti do të ndikoj drejtpërdrejt në ngritjen e cilësisë së shërbimeve që ofrohen nga AKF drejt mekanizmave tjerë të zbatimit të ligjit, dhe veçmas do të ndikoj në rritjen e profesionalizmit të personelit të saj. Shkëmbimi i përvojave dhe të arriturve në lëmin e forenzikës është e rëndësishme së veçantë për AKF. Përveç që është prioritet tashmë i konsoliduar i AKF, përcjellja e trendit të teknologjisë dhe praktikave më të mira të zhvilluara paraqet domosdoshmëri dhe nevojë konstante.

Në përputhje me këtë domosdoshmëri, dhe me qëllim që Divizionet/Laboratorët e AKF-së dhe stafi shkencor i tyre të jetë koherent me zhvillimet shkencore më të reja në lëmin e ndryshme forenzike në botë, dhe që metodologjitë dhe teknikat e përdorura të jenë në harmoni me standardet e pranuar ndërkombëtare, AKF planifikon të anëtarësohet në mekanizma dhe asociacione rajonale dhe ndërkombëtare.

4.2 Organizimi dhe pjesëmarrja në konferenca rajonale dhe ndërkombëtare

Agjencia e Kosovës për Forenzikë, synon dhe angazhohet që në bazë të mundësive të saja buxhetore por edhe me përkrahje të donatorëve, të organizoj konferenca ndërkombëtare në Kosovë, në fushën e forenzikës. Ajo gjithashtu do të marr pjesë në konferencat rajonale dhe ndërkombëtare që organizohen nga agjenci, institute e organizata të ndryshme në fushën e forenzikës.

4.3 Ngritja e bashkëpunimit me laboratorët e shteteve të rajonit

Lidhur me këtë objektiv specifik, AKF-ja synon bashkëpunimin me laboratorët e shteteve të rajonit përmes nënshkrimit të memorandumeve të mirëkuptimit, organizimit të trajnimeve të përbashkëta, takime pune, seminare etj. Ky bashkëpunim do të jetë i dobishëm ngase në të ardhmen si formë partneriteti do bëjmë të mundur që në disa fusha ku kemi mungesë të personelit apo pajisjeve të caktuara forenzike, të bëhen ekspertiza në ato laboratorë për llogari të AKF-së, dhe anasjelltas.

Kapitulli V: Zbatimi, monitorimi dhe vlerësimi i strategjisë

Procesi i implementimit të Strategjisë do të synojë përmbushjen e objektivave strategjike, atyre specifike dhe aktiviteve. Monitorimi dhe vlerësimi i rezultateve të efikasitetit të zbatimit të objektivave dhe aktiviteve do të jetë pjesë përbërëse e Procesit të Strategjisë, si dhe elemente kyçe në përmbushjen e saj. Monitorimi dhe vlerësimi janë mjete për matjen e përparimit në raport me objektivat e caktuar, për të vlerësuar nevojën e përcaktimit të rregullave të menaxhimit, në veçanti të aktiviteve. Procesi i monitorimit do të udhëhiqet nga Kryeshefi i AKF-së, me pjesëmarrje të gjerë të palëve të tjera të përfshira.

Sistemi i monitorimit dhe vlerësimit do të zgjerohet për të mbuluar të gjitha institucionet përgjegjëse për realizimin e objektivave të përcaktuara në strategjinë zhvillimore.

Agjencia e Kosovës për Forenzikë, si institucion udhëheqës për përmbushjen e objektivave, do të monitorojë indikatorët e Strategjisë Zhvillimore. Në fund të çdo viti, Kryeshefi i AKF-së do të përgatisë një raport progresi mbi realizimin e objektivave.

Kapitulli VI: Plani i Veprimit 2016-2020

Plani i Veprimit do të rishikohet në fund të çdo viti në mënyrë që të sigurohet zbatimi i kësaj Strategjie.

Plani i Veprimit për implementimin e kësaj strategjie përfshin:

- Objektivat strategjike;
- Objektivat specifike;
- Aktivitetet konkrete për implementim;
- Përcaktimin e institucioneve përgjegjëse dhe përkrahëse për përmbushjen e secilit objektiv;
- Specifikimin e kornizës kohore për përmbushjen e secilit aktivitet;
- Përcaktimin e burimeve të nevojshme financiare për zhvillimin e aktiviteteve;
- Përcaktimin e indikatorëve për implementimin e secilit objektiv dhe aktivitet.

STRATEGJIA ZHVILLIMORE E AKF-së 2016-2020

PLANI I VEPRIMIT

2016 – 2020

OBJEKTIVI STRATEGJIK

1. Përmirësimi i kushteve dhe hapësirave

1.1	<i>Zgjerimi dhe krijimi i hapësirës së mjaftueshme dhe të përshtatshme për punë</i>						
Nr.	Aktiviteti	Afati kohor	Buxheti	Institucio ni përgjegjës	Institucionet mbështetëse	Partner(ë)	Indikatorët e performancës
1.1.1	Krijimi i hapësirës së mjaftueshme për kryerjen e ekspertimeve Forenzike (Ndërtimi i aneks objektit të AKF-së).	2016-2019	2 000 000.00 €-i zotuar-	AKF	MPB, QEVERIA, DONATORËT.	OSCE, KE, ICITAP.	Numri i rasteve të kryera, rritja e cilësisë, sigurisë dhe fushave të reja të ekspertimit, zgjerim dhe krijimi i hapësirës së mjaftueshme.
1.2	<i>Blerja, furnizimi me pajisje, aparaturë dhe teknologji bashkëkohore në fushën e forenzikës.</i>						
Nr.	Aktiviteti	Afati kohor	Buxheti	Instituci oni përgjegj ës	Institucionet mbështetëse	Partner(ë)	Indikatorët e performancës
1.2.1	Blerja dhe pajisja me instrumente dhe aparatura të reja	2017-2020	1 300 000.00 €	AKF	MPB, QEVERIA, DONATORËT.	OSCE, KE, ICITAP.	Numri i ekspertizave të kryera, rritja e cilësisë dhe integritetit të

	(avancimi i teknologjisë) për kryerjen dhe zgjerimin e ekspertimeve forenzike në AKF.						ekspertimeve forenzike, si dhe përgjigja në afat kohor sa më të shkurtër.
1.2.2	Rifreskimi, përditësimi dhe avancimi i teknologjisë forenzike (Harduer, Softuer dhe sistemet e të dhënave: AFIS, IBIS, CODIS dhe LIMS) në AKF.	2016-2020	1 000 000.00 €	AKF	MPB, QEVERIA, DONATORËT.	OSCE, KE, ICITAP.	Rritja e sigurisë së të dhënave dhe arritja më e shpejtë dhe e avancuar deri të rezultatet gjatë analizimit dhe krahasimeve.
1.2.3	Blerja e një veturave për asistim në vend të ngjarjes dhe rekonstruim	2017-2020	20.000.00 €	AKF	MPB, QEVERIA, DONATORËT.	OSCE, KE, ICITAP.	Rritje e efikasitetit të punës operative.
1.2.4	Funksionalizimi i Divizionit për ekzaminim të Fotografive, Audiove dhe Zërit.	2016-2018	100 000.00 €	AKF	MPB, QEVERIA, DONATORËT.	OSCE, KE, ICITAP.	Fillimi i ekzaminimeve të rasteve të Imazhit digjital, Audiove dhe Zërit.
1.2.5	Funksionalizimi i Divizionit për Zjarrëvënie dhe Eksplozivë.	2016– 2019	200 000.00 €	AKF	MPB, QEVERIA, DONATORËT.	OSCE, KE, ICITAP.	Fillimi i ekspertimit të rasteve të zjarrëvënieve dhe eksplozivëve.

OBJEKTIVI STRATEGJIK:

2 . Zhvillimi i kapaciteteve njerëzore

2.1 2.1 Zhvillimi i qëndrueshëm dhe profesionalizimi i resurseve njerëzore.

Nr.	Aktiviteti	Afati kohor	Buxheti	Instituci oni përgjegj ës	Institucionet mbështetëse	Partner(ë)	Indikatorët e performancës
2.1.1	Krijimi i Njesisë për Prokurim, financa dhe personel në kuadër të strukturës organizative të AKF-së	2018-2019	Kosto Administrative- varësisht prej buxhetit për paga për stafin e ri përkates	AKF	MPB		Avancimi i kryerjes se shërbimeve specifike forenzike që kanë të bëjnë me prokurim, financa dhe Personel të AKF-së
2.1.2	Rekrutimi i personelit me qëllim të ngritjes së kapaciteteve të burimeve njerëzore prej 9 punonjësve të ri.	2018-2020	Kosto Administrative- varësisht prej buxhetit për paga.	AKF	MPB, QEVERIA.		Numri i stafit të pranuar, numri i ekspertimeve forenzike të kryera krahasuar me numrin e tanishëm dhe numri i fushave të reja të ekspertimeve forenzike.
2.1.3	Trajnimet bazike për fusha të reja të	2016-2020	30 000.00 €	AKF	MPB, QEVERIA, DONATORËT.	OSCE, KE, ICITAP.	Numri i fushave të reja të ekspertimeve forenzike

	ekspertimit forenzik.						në nivel të AKF-së.
2.1.4	Trajnime të avancuara (specializuara) për fusha të reja të ekspertimit forenzik.	2016-2020	20 000.00 €	AKF	MPB, QEVERIA, DONATORËT.	OSCE, KE, ICITAP.	Numri i avancimeve të fushave ekzistuese dhe numri i fushave të reja të ekspertimeve forenzike në nivel të AKF-së.
2.1.5	Pjesëmarrja në konferenca dhe seminare të fushave adekuate forenzike brenda dhe jashtë.	2016-2020	20 000.00 €	AKF	MPB, QEVERIA, DONATORËT.	OSCE, KE, ICITAP.	Rifreskimi dhe përditësimi i metodologjisë shkencore forenzike (shkëmbimi i përvojave më të mira) dhe rritja e bashkëpunimit në nivel rajonal dhe ndërkombëtar.
2.1.6	Kontrollet mjekësore vjetore	2016-2020	20 000.00 €	AKF	MPB, QEVERIA.		Mbrojta e shëndetit të punonjësve.
2.2	<i>Kontrolli i cilësisë dhe sigurisë përmes akreditimit dhe testeve profesionale.</i>						
Nr.	Aktiviteti	Afati kohor	Buxheti	Institucioni përgjegjës	Institucionet mbështetëse	Partner(ë)	Indikatorët e performancës
2.3.1	Akreditimi i	2017-2019	10 000.00 €	AKF	MPB, QEVERIA,	OSCE, KE,	Akreditimi i

	Laboratorëve/Divizionev e të AKF-së: Divizioni i Zjarrëvënjeve dhe Eksplozivëve, Divizioni i Ekzaminimit të Zërit, Audios dhe Videos, Divizioni për Ekzaminim të Kompjuterëve.				DONATORËT.	ICITAP.	Laboratorëve/Divizionev e të AKF-së që nuk janë akredituar.
2.3.2	Vazhdimi i akreditimit të Laboratorëve/Divizionev e të AKF-së të cilët janë akredituar.	2019-2020	25 000.00 €	AKF	MPB, QEVERIA, DONATORËT.	OSCE, KE, ICITAP.	Vazhdimi i akreditimit të Laboratorëve/Divizionev e të AKF-së të cilët janë akredituar.
2.2.3	Testet profesionale në periudha të caktuara	Vazhdimësi	10 000.00 €	AKF	MPB, QEVERIA, DONATORËT.		Ruajta e cilësisë dhe garantimi i sigurisë së shërbimeve forenzike.
2.3	<i>Hulumtime Shkencore në Bashkëpunim me MASHT dhe UP.</i>						
Nr.	Aktiviteti	Afati kohor	Buxheti	Instituci oni përgjegj ës	Institucionet mbështetëse	Partner(ë)	Indikatorët e performancës
2.4.1	Bashkëpunimi me Ministrinë e Arsimit,	2017-2020	Kosto administrative.	AKF	MPB, QEVERIA, DONATORËT.	OSCE, KE, ICITAP.	Numri i Memorandumeve të nënshkruara.

	Shkencës dhe Teknologjisë dhe Universitetin e Prishtinës.						
2.4.2	Publikimet.	2016-2020	5 000.00 €	AKF	Qeveria, MPB, MASHT,UP.	OSBE, ICITAP, KE, Donatorët.	Zhvillimin e fushave të reja nga forenzike-literaturë.
2.4.3	Hulumtimet.	2016-2020	10.000.00 €	AKF	Qeveria, MPB, MASHT,UP.	OSBE, ICITAP, KE, Donatorët.	Zhvillimin e fushave të reja nga forenzika-testim të metodave.
2.4.4	Ushtrimet praktike me studentë të Masterit.	2017-2020	50 000.00 €	AKF	Qeveria, MPB, MASHT,UP.	OSBE, ICITAP, KE, Donatorët.	Zhvillimin e fushave të reja nga forenzika.
2.4.5	Ushtrimet praktike për punime doktoraturash.	2016-2020	10.000.00 €	AKF	Qeveria, MPB, MASHT,UP.	OSBE, ICITAP, KE, Donatorët.	Zhvillimin e fushave të reja nga forenzika.

OBJEKTIVI STRATEGJIK:

3. Forcimi i bashkëpunimit ndër-institucional

3.1 *Memorandume mirëkuptimi dhe bashkëpunimi.*

Nr.	Aktiviteti	Afati kohor	Buxheti	Instituci oni përgjegj	Institucionet mbështetëse	Partner(ë)	Indikatorët e performancës
-----	------------	-------------	---------	------------------------------	------------------------------	------------	-------------------------------

ës							
3.1.1	Memorandum mirëkuptimi me KPK, KGJK, MASHT, UP.	2017-2020	Kosto administrative.	AKF	MPB, QEVERIA, DONATORËT.	OSCE, KE, ICITAP.	Rrit besimin në institucione, trajtimin reciprok të AKF-së me ato institucione.
3.2.2	Memorandume mirëkuptimi me Policinë e Kosovës.	2017-2020	Kosto administrative.	AKF	MPB, QEVERIA, DONATORËT.	OSCE, KE, ICITAP.	Rezultatet e arritura do të jenë të dobishme.
3.2	<i>Organizimi i përbashkët i takimeve, trajnime, seminareve, konferencave ndër-institucionale.</i>						
Nr.	Aktiviteti	Afati kohor	Buxheti	Institucioni përgjegjës	Instituci onet mbështetëse	Partner(ë)	Indikatorët e performancës
3.2.1	Organizimi i trajnimeve, seminareve të përbashkëta me Policinë, Gjykatat, dhe Prokurorinë.	2017-2020	10 000.00 €	AKF	MPB, QEVERIA, DONATORËT.	OSCE, KE, ICITAP.	Numri i takimeve të punës të organizuara.
3.2.2	Organizimi i konferencave të përbashkëta me Policinë, Gjykatat, dhe Prokurorinë.	2017-2020	15.000.00 €	AKF	MPB, QEVERIA, DONATORËT.	OSCE, KE, ICITAP.	Numri i trajnimeve të organizuara.

3.4.1	Organizimi i takimeve të përbashkëta vjetore me Policinë, Gjykatat, dhe Prokurorinë dhe Institucionet tjera të sigurisë dhe drejtësisë.	2017-2020	20 000.00 €	AKF	MPB, QEVERIA, DONATORËT.	OSCE, KE, ICITAP.	Numri i takimeve, rezultatet e arritura.
-------	---	-----------	-------------	-----	--------------------------	-------------------	--

OBJEKTIVI STRATEGJIK:

4. Rritja e bashkëpunimit ndërkombëtar

4.1	<i>Anëtarësimi në organizata-asociacione ndërkombëtare.</i>						
-----	---	--	--	--	--	--	--

Nr.	Aktiviteti	Afati kohor	Buxheti	Institucioni përgjegjës	Institucionet mbështetëse	Partner(ë)	Indikatorët e performancës
4.1.1	Aplikimi i AKF-së si anëtar i plotë në ENFSI.	2016-2020	5000.00 €	AKF	MPB, QEVERIA, DONATORËT.	OSCE, KE, ICITAP, UNDP.	Shkëmbimi i përvojave me të dhe rritja e bashkëpunimit në nivel rajonal dhe ndërkombëtar.
4.1.2	Aplikimi për anëtarësim në ENFSI, i divizioneve të AKF-së.	2016-2018	3000.00 €	AKF	MPB, QEVERIA, DONATORËT.	OSCE, KE, ICITAP, UNDP..	Qasja e Divizioneve në grupet punuese përkatëse në kuadër të ENFSI-i.
4.1.3	Pjesëmarrja në grupet	2016-2018	25 000.00 €	AKF	MPB, QEVERIA,	OSCE, KE,	Rifreskimi dhe

	punuese: punëtori, seminar, trajnim etj. (ENFSI; AAFS; IAFI; UKAS) etj.				DONATORËT.	ICITAP, UNDP.	përditësimi i metodologjisë shkencore forenzike (shkëmbimi i përvojave me të mira) dhe rritja e bashkëpunimit.
4.1.4	Pjesëmarrja në teste grupore në fusha të ndryshme.	2016-2018	2 000.00 €	AKF	MPB, QEVERIA, DONATORËT.	OSCE, KE, ICITAP, UNDP.	Sigurimi i cilësisë, përmes krahasimeve ndër laboratorikë.
4.1.5	Vizita studimore.	2016-2018	5 000.00€	AKF	MPB, QEVERIA, DONATORËT.	OSCE, KE, ICITAP, UNDP.	Shkëmbimi i përvojave me Institucionet homologe të cilat janë të akredituar me ISO 17025.
4.2	4.2. Organizimin dhe pjesëmarrja në konferenca rajonale dhe ndërkombëtare.						
Nr.	Aktiviteti	Afati kohor	Buxheti	Institucioni përgjegjës	Institucionet mbështetëse	Partner(ë)	Indikatorët e performancës
4.2.1	Pjesëmarrja ndërkombëtare në konferenca Forenzike.	2016-2020	100 000.00 €	AKF	MPB, QEVERIA, DONATORËT.	OSCE, KE, ICITAP, UNDP.	Shkëmbimi i përvojave me të dhe rritja e bashkëpunimit në nivel rajonal dhe ndërkombëtar sipas standardit

							ndërkombëtar ISO 17025.
4.2.2	Trajnime me akterë tjerë në fushën e Forenzikës.	2016-2020	50 000.00 €	AKF	MPB, QEVERIA, DONATORËT.	OSCE, KE, ICITAP, UNDP.	Shkëmbimi i përvojave me të dhe rritja e bashkëpunimit në nivel rajonal dhe ndërkombëtar sipas standardit ndërkombëtar ISO 17025, të arriturat e reja në fushën e Forenzikës si: pajisjet, teknologjia e re, metodat e reja shkencore etj.
4.3	<i>Bashkëpunimi me laboratorët e shteteve të rajonit.</i>						
Nr.	Aktiviteti	Afati kohor	Buxheti	Instituci oni përgjegj ës	Institucionet mbështetëse	Partner(ë)	Indikatorët e performancës
4.3.1	Studime (trajnime) të përbashkëta me laboratorë të forenzikës në shtetet rajonale.	2016-2020	25.000.00 €	AKF	MPB, QEVERIA, DONATORËT.	OSCE, KE, ICITAP, UNDP.	Shkëmbimi i përvojave me Institucionet homologe të cilat janë të akredituar me ISO 17025.